



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Nr. 189 Prot.

Kukës, më 22.05.2025

Lënda: Shpallje vend të lirë pune.

Drejtuar: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

TIRANË


Në zbatim të ligjit Nr.152/2013, të miratuar më datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Këshilli i Qarkut Kukës, shpall procedurën e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë, për pozicionin:

Drejtor drejtorie pranë Drejtorisë Financës, Juridike, MBNJ dhe Shërbimeve

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

KRYETARI

ASTRIT DOBRUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KUKES

**SHPALLJE
PER LEVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NE DETYRE**

**Lloji i diplomes “Ekonomik-administrim biznes”
niveli minimal i diplomes “Master Shkencor”**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe të Kreut II, dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Burimet Njerezore shpallin procedurën e lëvizjes paralele/të ngritjes ne detyre/pranim nga jashtë, për pozicionin:

1(nje) Drejtor Drejtorie pranë Drejtorisë Financës, Juridike, MBNJ dhe Shërbimeve.

(Kategoria e Pages II-2)

Pozicionet më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes ne detyre.

Për të tre procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje ne detyre) aplikohet në të njëjtën kohë !

Afati për dorëzimin e dokumentave për - **LEVIZJE PARALELE:** **27 Maj 2025**

Afati për dorëzimin e dokumentave për - **NGRITJE NE DETYRE:** **30 Maj 2025**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si me sipër është:

- Përgatitjen e P/buxhetit të vitit të ri financiar, rishimin e tij gjate vitit si dhe mbylljen e buxhetit të vitit të mëparshëm sipas afateve dhe normave të parashikuara në ligj.
- Hartimin e bilancit përfundimtar sipas kërkesave, normave, procedurave dhe afateve të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore.
- Hartimin e raporteve ekonomiko-financiare dhe paraqitjen e tyre per miratim ne Keshillin e Qarkut Kukës
- Shpërndarjen e buxhetit të miratuar, sipas strukturave te institucionit, si dhe transferimin e buxhetit tek ndërmarrjet e vartësise.

- e. Përmbushjen në kohë dhe masën e duhur të pagesave, të detyrimeve përkatëse ndaj te treteve, si dhe marrjen e masave për sigurimin dhe çeljen e fondeve në përputhje me llogarite financiare.
- f. Rakordimet me Degën e Thesarit për çeljen e fondeve dhe realizimin faktik të tyre si dhe te shpenzimeve sipas periudhave mujore dhe vjetore.
- g. Përpilimin e liste-pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi pagë dhe mbi shperblimet si dhe hedhjen e tyre ne sistemin elektronik per çdo muaj.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda te njejtës kategori,
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë te nivelit “Master Shkencor” ne Ekonomi, Finance. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet te jete ne te njejten fushe.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë prane njesise se burimeve njerezore te Keshillit te Qarkut Kukes per pozicionin qe deshirojne te aplikojne, dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar ne perputhje me dokumentin tip qe e gjeni ne linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b. Fotokopje të diplomës
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Vërtetim nga institucioni qe nuk ka mase disiplinore ne fuqi.
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Dokumentat duhet të dorëzohen me poste apo drejtpërsëdrejti prane Njesise se Burimeve Njerezore te Keshillit te Qarkut Kukes brenda dates **27 Maj 2025**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **30 Maj 2025**, Njesia e Burimeve Njerezore në Keshillin e Qarkut Kukes, do të shpallë në portalin “*Sherbimi Kombetar i Punesimit*”, në faqen e zyrtare te internetit të institucionit dhe ne stenden

e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njesia e Burimeve Njerëzore, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos-kualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a) Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen vendore”.
- b) Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015
- c) Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- d) Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- e) Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- f) Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”
- g) Ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise,, i ndryshuar me ligjin nr. 57 datw 02.06.2016
- h) Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015;
- i) Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- j) Udhwzimin Nr. 2 date 06.02.2012 “Per Proçedurat Standarte te zbatimit te buxhetit”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Kukës do të shpallë fituesin në portalin “*Sherbimi Kombëtar i Punësimit*” në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në stendin e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NE DETYRE

Vetem në rast se pozicioni i renditur ne fillim te kesaj shpalljeje, ne perfundim te procedures së lëvizjes paralele, rezulton se ende ky pozicion eshte vakant, ky pozicion eshte i vlefshem per konkurimin nepermjet procedures se ngritjes ne detyre. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare te internetit të Keshillit te Qarkut Kukes dhe ne stenden e informimit të publikut duke filluar nga data **30 Maj 2025**

Per kete procedure kane te drejte te aplikojne vetem nepunesit civile te nje kategorie paraardhese (vetem nje kategori me e ulet), te punesuar ne te njejtin institucion tjetër te sherbimit civil, qe plotesojne kushtet per ngritjen ne detyre dhe kerkesat e veçanta per vendin e lire.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATET:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati per procedure e ngritjes ne detyre janë:

- Të nepunes civil I konfirmuar ne kategorine III-b, IV-a, IV-b;
- Të mos kete mase disiplinore ne fuqi (te vertetuar me nje document nga institucioni);
- Të kete te pakten vleresimin e fundit “Mire” ose “Shume mire”;
- Niveli I diplomes duhet te jete “Master Shkencor”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë te nivelit “Master Shkencor“ ne Ekonomik, si dhe diploma e nivelit Bachelor duhet te jete ne te njejten fushe.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b) fotokopje të diplomës (perfshire dhe diplomen bachelor);
- c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g) Vleresimin e fundit nga eprori direkt;
- h) Vertetim nga institucioni qe nuk ka mase disiplinore;
- i) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt ne Njesine e Burimeve Njerëzore ne Keshillin e Qarkut Kukes brenda dates **30 Maj 2025**

2.3 REZULTATET PER FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Ne daten **04 Qershor 2025** Njesia Pergjegjese e Keshillit te Qarkut Kukes do te shpalle ne faqen zyrtare te Keshillit te Qarkut Kukes dhe ne portalin “*Sherbimit Kombetar te Punesimit*”, listen e kandidateve qe plotesojne kushtet dhe kerkesat e posaçme per proceduren e ngritjes ne detyre si dhe daten, vendin dhe oren e sakte ku do te zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Ne te njejten date kandidatet qe nuk i plotesojne kushtet dhe kriteret e vecanta per proceduren e ngritjes ne detyre do te njoftohen individualisht ne menyre elektronike nga njesia pergjegjese, per shkaqet e moskualifikimit (nepermjet adreses se e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohurite mbi:

- a. Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen vendore”.
- b. Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015
- c. Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- d. Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- e. Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- f. Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës se Shqiperise”
- g. Ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise,, i ndryshuar me ligjin nr. 57 datw 02.06.2016
- h. Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015;
- i. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- j. Udhwzimin Nr. 2 date 06.02.2012 “Per Proçedurat Standarte te zbatimit te buxhetit”

Kandidatët gjate intervistes se strukturuar me goje do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite, aftesite, kompetencat ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes;
- b. Eksperiencen e tyre te meparshme
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmerite e tyre per karrieren.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, te lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore Kukes do të shpalle fituesin ne faqen zyrtare dhe ne portalin “*Sherbimi Kombetar i Punesimit*”. Te gjithë kandidatet pjesmarres ne kete proçedure do te njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për proçedurën e ngritjes ne detyre, do të marrin informacion në faqen e internetit te institucionit, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- Per daten e daljes se rezultateve te verifikimit paraprak,
- Datën, vendin dhe oren ku do te zhvillohet konkurimi duke filluar nga data **4 Qershor 2025**